



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 2776 Prot.

Ballsh, më 19.05. 2022

VENDIM

Nr. 26, Datë 18/05/2022

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 31, DATË 19.04.2018 "PËR MIRATIMIN E VLERËS SË SHPRONËSIMIT TË QYTETARËVE ALBERT MEÇANAJ, ADRIAN HAZIZAJ, KASTRIOT TAULLAJ NË KUADËR TË ZBATIMIT TË PROJEKTEVE TË BASHKISË MALLAKASTËR"

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" i ndryshuar, të VKM-së nr. 401, datë 23.10.1989 "Për miratimin e normave të reja të amortizimit të makinerive e të pajisjeve dhe të mjeteve të transportit", të VKM-së nr. 138, datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërbllimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të VKM-së nr. 89, datë 02.06.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", të projektit "Rikualifikimi Urban i lagjes 28 Nëntori të qytetit Ballsh, Mallakastër", të shkrësës nr. 44/6 prot., datë 04.05.2022 "Kthim përgjigje", të Komisionit të Posaçëm për Shpronësim, administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 164/6 prot., datë 05.05.2022, si dhe referuar situacionit të punimeve të objektit të z. Adrian Hazizaj,

VENDOSI:

1. Në gërmën b, pika 1 e Vendimit nr. 31, datë 19.04.2018 "Për miratimin e vlerës së shpronësimit të qytetarëve Albert Meçanaj, Adrian Hazizaj, Kastriot Taullaj në kuadër të zbatimit të projekteve të Bashkisë Mallakastër", bëhet ky ndryshim:
Miratimin e vlerës paraprake të shpronësimit si më poshtë (referuar situacionit të punimeve të objektit të z. Adrian Hazizaj):
 - a. Z. Adrian Hazizaj - Vlera Totale e shpronësimit = 360 814 (treqind e gjashtëdhjetë mijë e tetëqind e katërmëdhjetë) lekë.
2. Vendimi nr. 14, datë 28.02.2022 "Për një ndryshim në Vendimin nr. 31, datë 19.04.2018 "Për miratimin e vlerës së shpronësimit të qytetarëve Albert Meçanaj, Adrian Hazizaj, Kastriot Taullaj në kuadër të zbatimit të projekteve të Bashkisë Mallakastër", shfuqizohet.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZV/KRYETAR

Nexhmi Sulaj